



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040 Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës 2008/28, nenit 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, nenit 4 paragrafi 1 të Rregullores për ndarjen e ndihmave momentale në të holla nr. 01-013/860 të datës 17.07.2012, Kryetari i Komunës së Vitisë shqyrtoi kërkesën e Shoqatës së Pensionistëve të Komunës së Vitisë dhe lidhur me këtë morri këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E NDIHMES FINANCIARE NË SHUMË
PREJ 350,00€ SHOQATËS SË PENSIONISTËVE TË KOMUNËS SË VITISË

I.

Me këtë Vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë I **NDAN** ndihmë financiare në shumë prej 350,00 (treqind e pesëdhjetë euro), Shoqatës së Pensionistëve të Komunës së Vitisë në emër të mbështetjes financiare për kryerjen e aktiviteteve të kësaj shoqate.

II.

Mjetet nga neni 1 i këtij Vendimi, sigurohen nga Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2016 nga kodi buxhetor për subvencione i Zyrës së Kryetarit të Komunës së Vitisë.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi derdhen në llogari të Shoqatës së Pensionistëve në Viti.

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Zyra e Thesarit e Komunës së Vitisë.

IV.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës së Vitisë.

02.Nr.07/306
Viti, 31.03.2016

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
Sokol Haliti

Vendimi u dorëzohet:

1. Xhemajl Rustemi - Kryetarit të shoqatës
2. Zyrës së thesarit dhe
3. Arkivi